

LIGJ
Nr.8311, datë 19.3.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7678, DATË 3.3.1993 “PËR AKCIZAT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8247, DATË 2.10.1997**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 3 të ligjit nr.7678, datë 3.3.1993 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8247, datë 2.10.1997, paragrafi i parë pas pikës “Dh” ndryshohet si vijon:

“Importimi i çdo lloj nënprodukti naftë që nuk përfshihet në pikën “Dh”, trajtohet me akcizë 300 për qind, përveç vajgurit të vendit që trajtohet me akcizë 110 për qind dhe vajgurit të importit që trajtohet me akcizë 150 për qind.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në datën e shpalljes nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2026, datë 24.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.